

Mr. Fahredin SHABANI

## NGJARJE E RËNDËSISHME ARSIMORE

Zhvillimi i mëtejshëm i arsimit kombëtar, veçanërisht pas Kongresit të Manastirit, përhapja e vrullshme e mësimin në shqipet si dhe të shumë shkollave në gjuhën tonë amtare, shtruan dukshëm nevojën e organizimit të rrjetit të arsimit mbi baza kombëtare në një shkallë më të avancuar. Gjithsesi, Kongresi i alfabetit, i njohur me emrin Kongresi i Manastirit, më 1908, si dhe më pas ai i Dibrës, që shënoi disfatën e thellë të politikës xhonturke, ndikuan në ngritjen e vetëdijes kombëtare shqiptare, duke i hapur Lëvizjes e Rilindjes Kombëtare Shqiptare perspektiva të reja, posaçërisht në lëmin e arsimit e të kulturës shqiptare, në përgjithësi.

Është koha kur shqiptarët dhe xhonturqit ishin ku e ku gati në fushën e armëve të luftës, kur këta të fundit fund e krye nuk i kishin plotësuar kërkesat e shqiptarëve. Para së gjithash këtu kihej të bëhej me injorimin e zbatimit të shqipes në shkollat shtetërore si dhe në sigurimin e mjeteve të nevojshme financiare për shkollat dhe mësuesit e gjuhës shqipe.

E gjithë kjo, më pas, do të shtrojë përpara militantëve më të dalluar të Lëvizjes e të Rilindjes Kombëtare Shqiptare detyra dhe obligime të reja në planin e arsimit kombëtar. Ishte, ndërmjet të tjerash, një nevojë më se e ngutshme për të organizuar edhe një tubim me karakter thjesht kombëtar, në të cilin do të shtroheshin bazat e shëndosha të arsimit në gjuhën shqipe. Në fakt, shqiptarëve u nevojitej si buka një shkollë e mesme, e cila do të përgatiste në të ardhmen kuadro të nevojshme mësuesish me vlera të njëmendta pedagogjike e edukative.

Pas Kongresit të Manastirit, në viset e banuara me shqiptarë nisi të vërehej tendenca e përpjekjeve drejt përhapjes së shpejtë të mësimin shqip, përkatësisht të hapjes së dhjetëra shkollave dhe kurseve në gjuhën tonë. Të gjitha këto shtruan domosdonë

e zgjidhjes të një varg problemesh të rëndësishme me karakter pedagogjik, organizativ dhe financiar, si: përgatitjen e mësuesve për shkollat shqipe; përpunimin e një programi të vetëm për to; organizimin më të mirë, në shkallë kombëtare të rrjetit shkollor, që ishte krijuar dhe që ishte duke u zgjeruar; sigurimin e mjeteve të nevojshme financiare për mbajtjen e shkollave dhe pajisjen e tyre me tekste e mjete mësimore; njësimin e gjuhës së shkruar, që do të përdorej në botimet shkollore e joshkollore.

Këto probleme, dhe të tjera me karakter politik e organizativ të Lëvizjes Kombëtare, e bënë të nevojshme thirrjen e një Kongresi të ri mbarëshqiptar. Duke marrë parasysh se para arsimit kombëtar dilnin probleme të mprehta, iniciator për thirrjen e një kongresi të ri kombëtar u bë Klubi Shqiptar i Selanikut. Në thirrjen drejtuar gjithë klubeve e shoqërive shqiptare, që mbante datën 25 mars 1909,<sup>1</sup> si vend për mbajtjen e Kongresit caktohej qyteti i Elbasanit, dhe si kohë 14 maji 1909. Në thirrje parashikohej, gjithashtu, rendi i ditës, i cili përmbante këto çështje:

1. Çelja e shkollave të reja shqipe, përcaktimi i numrit dhe i vendit;
2. Çelja e një shkolle normale;
3. Mënyra si do të mbaheshin shkollat, ku dhe si do të siguroheshin mjetet e nevojshme financiare;
4. Programi dhe struktura e shkollave shqipe;
5. Buxheti i shkollave dhe zgjedhja e mësuesve;
6. Caktimi i një inspektori për të gjitha shkollat shqipe;
7. Krijimi i një qendre për organizimin dhe kontrollin e shkollave;
8. Si do të veprohej që qeveria xhonturke të çelte shkolla shqipe dhe që shkollat greke të ktheheshin në shkolla kombëtare dhe
9. Lidhja e klubeve midis tyre dhe hartimi i një programi të përbashkët.<sup>2</sup>

Përfaqësuesit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, të vetëdijshtëm se xhonturqit me politikën e tyre shoviniste dëshironin t'i minonin të gjitha frytet e aktivitetit të shqiptarëve, dhe njëkohësisht, duke u frikësuar nga separatizmi kombëtar që mund ta krijonte zbatimi i alfabetit arab,<sup>3</sup> vendosën të thërrisnin Kongresin në Elbasan, që në histori njihet me emrin "Kongresi për shkolla".<sup>4</sup> Për më tepër, pozita gjeografike e Elbasanit në kërthizë të Shqipërisë ka qenë e favorshme për delegatët që të merrnin pjesë aktive në këtë tubim me karakter kombëtar. Elbasani, po ashtu, ka pasur tradita

për lëvrimin e gjuhës amtare.<sup>5</sup> Figurat e shquara të Elbasanit, si Dhaskal Todhri, Konstantin Kristoforidhi e të tjerë kanë qenë personalitete të njohura në tërë Shqipërinë dhe kanë ndikuar në ata intelektualë që vendosin për mbledhjen e Kongresit në këtë qytet.<sup>6</sup>

Nisur nga kjo, klubet e Elbasanit “Bashkimi” dhe “Vllazëria” bënë përgatitjet për të pritur delegatët, ndërsa Klubi “Bashkimi” lajmëroi gjithashtu klubet e tjera që të dërgonin delegatët e tyre. Kongresi nuk i mbajti seancat e veta në datën e caktuar, pasi në Stamboll, gjatë muajit prill, ndodhën trazira të shkaktuara nga elementët reaksionarë osmanë me Sulltan Abdyl Hamitin në krye. Ideja e thirrjes së Kongresit megjithatë po bëhej realitet, kur komisioni organizativ vendosi që tubimi të mbahej në ditët e para të shtatorit të vitit 1909.

Kështu, më 2 shtator të vitit 1909, 55 delegatë nga shoqëritë dhe klubet e ndryshme shqiptare prej Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut arritën në Elbasan një ditë më parë dhe gjetën një atmosferë të ngrohtë në klubet e këtij qyteti, “Bashkimi” e “Vllazëria”. Xhonturqit, të befasuar me këtë tubim të organizuar nga ana e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, dhe për t’i penguar punimet, e veçanërisht vendimet me karakter gjithëkombëtar që mund të aprovohehin, reaguan shpejt, duke synuar të shkaktonin përçarje në radhët e delegatëve, që në fakt nuk ia dolën. Punimet e Kongresit të Elbasanit i përcolli edhe diplomacia austro-hungareze nëpërmjet agjenturës së vet. Vend të rëndësishëm këtu zunë çështjet kulturore dhe arsimore, të cilat pa ndërprerë i kishte shtruar dhe po i shtronte në rendin e ditës deri atëherë Lëvizja Kombëtare Shqiptare. Kongresin e kryesoi Dervish Hima, i cili u zgjodh kryetar, ndërsa Mit’hat Frashëri zuri postin e nënkryetarit.<sup>7</sup>

Gjatë diskutimeve të përgjithshme, delegatët e Kongresit të Elbasanit aprovuan një rezolutë që përbëhej prej 15 pikave.<sup>8</sup> Kështu, gjatë muajit shtator parashihej që në Elbasan të hapet shkolla normale, ku procesi edukativo-arsimor do të zhvillohej në gjuhën amtare. Lidhur me këtë, të gjitha klubet dhe shoqëritë shqiptare u zotuan të ndihmonin me mjete materiale këtë vendim.<sup>9</sup> Kongresi vendosi që për mbajtjen e kësaj shkolle, sa për fillim, të shpenzohen 700 lira turke. Po ashtu, aty u mur vendim

që kjo shkollë e mesme shqipe, e para e llojit të tillë në Shqipëri, të kishte 6 klasë, një personel mësimor prej 7 personash, kurse njeri prej tyre do të kryente edhe detyrën e drejtorit.<sup>10</sup>

Kongresi i Elbasanit vendosi që Klubi i Manastirit "Bashkimi" gjatë dy viteve të ardhshme përsëri të luajë rolin e klubit qendror për të gjitha shoqëritë dhe klubet shqiptare. Pasi që dialekti i Elbasanit ishte shumë i përshtatshëm, në këtë tubim, nëpërmes rezolutës iu bë thirrja të gjithë shkrimtarëve shqiptarë ta respektojnë këtë drejtshkrim në veprimtarinë e tyre artistike, veçanërisht në shtypjen e literaturës shkollore.<sup>11</sup> Për të drejtuar sa më mirë veprimtarinë e fondit ndihmëtar të Korçës, Kongresi zgjodhi një komision dhe e votoi zgjidhjen e një këshilli drejtues i përbërë prej Dervish Himës, Haki Begut, Mit'hat Frashërit, etj.<sup>12</sup> Në Elbasan, gjithashtu, u diskutua rreth pozicionimit të mëtejshëm ndaj regjimit xhonturk, me ç'rast u shpreh armiqësia e shqiptarëve ndaj Komitetit "Bashkim e Përparim". Kështu, duke folur për armiqësinë e shqiptarëve me regjimin xhonturk, Konsulli austro-hungarez shkruante në raportin dërguar rreth punimeve të Kongresit të Elbasanit se "pjesa më e madhe e shqiptarëve janë armiq të regjimit xhonturk". Shumë prej tyre shprehën bindjen se Komiteti "Bashkim e Përparim" sa për sy e faqe është në favor të shqiptarëve.<sup>13</sup>

Të gjitha vendimet që u aprovuan nga delegatët në Kongresin e Elbasanit, shfaqën në fakt kërkesat themelore të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Aty u trajtuan edhe shumë probleme të tjera që kishin ekskluzivisht karakter të përgjithshëm politik. Raporte të shumta të asaj kohe qartë dëshmojnë se delegatët e Kongresit, duke vënë në jetë udhëzimet e klubeve, ngritën edhe problemet politike, shqyrtuan qëndrimet politike ndaj komitetit xhonturk "Bashkim e Përparim" si dhe ndaj ndërhyrjeve të Fuqive të Mëdha në punët e brendshme të çështjes shqiptare.<sup>14</sup>

Sidoqoftë, për shkak të një varg rrethanash të vështira, Normalja e Elbasanit nuk u hap as më 14 shtator të vitit 1909 dhe as më 16 nëntor, siç e ishte paraparë. Hapja aq shumë e prituri sipas rekomandimeve të Kongresit kombëtar për shkollën në Elbasan ndodhi përfundimisht më 1 dhjetor të vitit 1909. Kështu, Normalja e Elbasanit i hapi dyert për shumë nxënës nga mbarë hapësira etnike shqiptare, ndërsa, sipas pjesëmarrësve, e

gjithë kjo u shndërrua në një “festë kombëtare”, ku mori pjesë “i tërë populli i Elbasanit”.<sup>15</sup>

Në anën tjetër, me rastin e fillimit të këtij akti të madh historik, drejtori i parë i kësaj shkolle me vlerë për arsimin gjithëkombëtar, Luigj Gurakuqi, me një fjalim të zjarrtë, do të vinte në dukje se: “Shqipëria u lëkund e tëra nga zëri i shkollës Normale; atdhetarët shqiptarë, që prej sa kohe kishin një etje të madhe për mësim e për dituri, nuk i kursyen ndihmat e veta të begata, e djemtë tanë erdhën nga të gjitha viset e Shqipërisë, e u derdhën këtu në Elbasan. Kështu që sot mund të themi me një pëlqim të parrëfyeshëm se kjo shkollë, e cila u hap e u nis nga vetëm me 50 nxënës, sot ka të shkruar më tepër se 150, të ndarë në katër rende, një të shkollës fillore e tri të Premtares! E jo vetëm nga Toskëria, që ka qenë gjithmonë e para ndër tregimet kombëtare e ndër luftëtarët e gjuhës, po më fort nga Gegëria e sipërme, nga ajo Kosova fisnike e trimoshe, me të përpjekurit e të ndershmit Hasan be Prishtina, i cili na rroftë për jetë, na erdhën mjaft nxënës, sa që mund të thuhet, pa frikë lajthimi” se nuk ka kënd të Shqipërisë, që mos të ketë këtu brenda përfaqësuesin e tij”.<sup>16</sup> Po ashtu, mbi aktin solemn të Normales së Elbasanit, profesorit të mirënjohur të gjuhës shqipe Aleksandër Xhuvani do t’i kujtohet se: “Në Normalen e Elbasanit u mblodhën atëherë nxënës nga të gjithë viset e Shqipërisë e në mes tyre edhe shumë nxënës nga Kosova, të mbledhur e të dërguar me përpjekjet e patriotit kosovar Hasan Prishtina. L. Gurakuqi u zgjodh drejtor i shkollës. Ndër profesorët e asaj shkolle ia vlen që të përmenden, veç meje dhe Gurakuqit: Sotir Peci, Pjetër Dodbiba, Simon Shuteriqi, Hasan Mezja dhe Hafiz Ibrahim Dalliu nga Tirana. Normalja punoi për një vit plot.”<sup>17</sup>

Normalja e Elbasanit kështu filloi jetën e vet të rëndë arsimore me ardhjen e 50 nxënësve nga Kosova, d.m.th., rreth një e treta e gjithë nxënësve kishin ardhur, siç bënte të ditur L. Gurakuqi, “nga ajo Kosovë kreshnike që ka kurdoherë trima e skifterë”.<sup>18</sup> Mbase, si shkollë mbarëshqiptare që ishte, Normalja arsimoi në gjirin e saj shumë të rinj nga Prishtina, Peja, Gjakova, Prizreni, Vushtrria, Mitrovica, Gjilani, Shkupi, Dibra” Struga, Pogradeci, Shkodra, Elbasani, Berati, Gjirokastra, Përmeti, Delvina, Libohova, Peqini, Kruja, Tirana, Kavaja etj.<sup>19</sup> Shumë nga ata kështu, ndërprejnë

mësimet në idadijet e ruzhdijet osmane ose nga gjimnazet greke, duke u regjistruar në Normalen e preferuar nga Kongresi i Madh i Arsimit Kombëtar këtu në Elbasan. E gjithë kjo po dëshmonte vullnetin e madh të prindërve të tyre që fëmijët të mësojnë në shqipet e t'i shërbejnë arsimit kombëtar. Hapja e Normales së Elbasanit ishte mbi të gjitha kurorë e përpjekjeve të mëdha dhe realizimi i një propagande efektive të rilindësve që pati vulën e vet në Kongresin e mbajtur në Elbasan dhe në vendin për hapjen e shkollës së parë të mesme në gjuhën shqipe në truallin amë. Ishte, me fjalë të tjera, ky një akt i forcimit të ndjenjave kombëtare dhe të shenjtërimit të gjuhës e të shkollës shqipe.

Hapja e Normales në Elbasan i dha dorë edhe atdhetarit të devotshëm për independencën, për shkrimin shqip, për kulturën dhe arsimin kombëtar, Dervish Himës, të propagandonte vendimet e ligjshme të Kongresit të Elbasanit në favor të arsimit kombëtar. Ndërmjet të tjerash, ai do të vente në dukje se "Ne kemi themeluar një shkollë Normale në Elbasan për të përgatitur mësuesit që na duhen për shkollat shqipe. Në këtë shkollë kanë dërguar djemtë e tyre edhe shqiptarët e Kosovës. Kjo është një përgjigje e mirë për të gjithë ata që duan ta paraqesin Shqipërinë e sipërme si refraktare ndaj arsimit e përparimit kombëtar. Po kështu, kemi hapur shkolla në Shkup, për të përhapur mësimin shqip në kombin shqiptar".<sup>20</sup>

Nisur nga shtatori dhe dhjetori i vitit 1909, mu në kohën e reaksionit xhonturk gati se paraqesin muaj kulmorë të Rilindjes e të emancipimit kombëtar. Rilindja Kombëtare arriti fitoren e madhe me vendimet historike të Kongresit kombëtar të Elbasanit i njohur edhe si kongres për shkollën kombëtare shqipe, si kongres për shkolla, duke dhënë kështu një kontribut të pamohueshëm në përhapjen e arsimit e të kulturës në gjuhën amtare. Nuk ishte e rastit, prandaj, që Kalendarin "Korça" këtë kongres e vlerësonte si më të shënuarin nga të gjitha kongreset që ishin bërë në vendin tonë pas shpalljes së Kushtetutës turke.<sup>21</sup> Libri i përvitshëm "Shqiptari", më 1911, duke dhënë mendimin për rëndësinë historike të këtij kongresi, thotë: « ... Nër të gjithë këso kongrese<sup>22</sup> ai i Elbasanit shkëlqeu si më i vlefshëm edhe ma i frytshëm ... ».<sup>23</sup> Jehona e Kongresit kombëtar të Elbasanit, për shkolla, u përhap edhe në gjirin e kolonive shqiptare të mërgimit.

Një radhë patriotësh të vendosur, në kurbet, në vise të Ballkanit e të Turqisë, me anë telegramesh, dërgonin urime të përzemërta dhe ndihma në të holla.<sup>24</sup>

Rrjedhimisht nga kjo, Kongresi i Elbasanit për shumëçka u vlerësua atëherë si ngjarje nga më madhoret gjatë fazës së katërt të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. “Kongresi për shkolla” me fjalë të tjera ishte kuvendi ku pas një lufte të gjatë prej disa shekujsh shqiptarët realizuan dëshirën e themelimit të një shkolle të mesme në gjuhën amtare. Së dyti, aty shihet fryma mobilizuese e ngritjes së ndërgjegjes kombëtare jo vetëm në planin arsimor, por edhe në atë politik, duke i bërë të ditur opinionit ndërkombëtar, aspiratat e shqiptarëve për liri e pavarësi.

## Shënime:

<sup>1</sup> Stefanaq Pollo-Selami Pulaha, Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare (1878-1912), Tiranë 1978,119; Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes kombëtare, vëll. II, Tiranë 1976, 444-445.

<sup>2</sup> Hysni Myzyri, Arsimi kombëtar shqiptar (1908-1912), Prishtinë 1996, 146.

<sup>3</sup> “Vjasti”, viti XX, nr. 51, 27.01.1910, Stamboll, 1.

<sup>4</sup> Petraç Pepo, Kongresi i Elbasanit, shoqëria shkollore “Përparimi” dhe ngritja e shkollës Normale-Ngjarjet e shënuara në historinë e zhvillimit të arsimit dhe të kulturës në vendin tonë, Tiranë 1972, 1.

<sup>5</sup> Po aty

<sup>6</sup> Po aty.

<sup>7</sup> I. G. Senkevic, Osvoboditelno dvizenie Albanskovo naroda 1905-1912, Moskva 1959, 147-148.

<sup>8</sup> "Vjasti", viti XIX, nr. A, 12. IX. 1909, Stamboll, 2.

<sup>9</sup> “Bashkimi i Kombit”, nr. 1, 10 shtator1909, Manastir.

<sup>10</sup> Po aty.

<sup>11</sup> M. Kodra, Albansko osvoboditelno dvizenie, “Glasnik na Institut za nacionalnia istoria”, Skopje 1968, 121.

<sup>12</sup> “Vjasti”, viti XIX, nr. 4, 12.09.1909 Stamboll, 2.

<sup>13</sup> HHSTA PA A, Raporti i konsulit austro-hungarez në manastir dërguar ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë. Në këtë raport thuhet edhe këto: ... Mit’hati nuk e mbajti dot zemërimin, prandaj lëshoi nga goja shprehjen fyese: “hëngshit njërit tjetrit gjë që shkaktoi indinjatë të përgjithshme ... shih Alfabeti